

Vishegradit, më 4.08.1998.

Burimet: deklarata Z.B, FDH-36228; FHP, *Haški tribunal, Sudeenje Slobodanu Miloševiću*, III,118; SMIP, *Teroristički...*, III, 936; KKMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 15; Z. Stijović, *Kosmet...*, 109.

Zef (Gjon) Krasniqi

(28.02.1940, shqiptar nga fshati Meqe/Meçe, komuna e Gjakovës/Đakovica, pensionist, shtatë fëmijë)

Zefi ka punuar në Zvicër dhe Austri për dhjetë vjet. Në vitin 1985, u kthye në fshatin e lindjes në Meqe/Meçe, në Kosovë, dhe u punësua si vozitës në kooperativën bujqësore *Bec*. U pushua nga puna në vitin 1990, por ia arriti që të fitonte pensionin në bazë të invaliditetit. Në datën **2.08.1998**, kur forcat serbe hyrën me tanket në **Meqe/Meçe**, Zefi me djemtë dhe farefisën ka marr pjesë në mbrojtjen e fshatit nga pozicioni i quajtur *Lugu i Goranit/Goranska kotlina*. Nga ora 15:00, të gjithë pjesëtarët e UÇK-së u tërhoqën përpos Zefit. Tri orë më vonë, Zefi ka rënë gjatë betejës me pjesëtarë të forcave serbe. Ata e bartën trupin e tij në Gjakovë/Đakovica, ku u varros në varrezat e qytetit më 9.08.1998. Në datën 20.09.1998, familja e ka rivarrosur atë në varrezat e fshatit të Doblubarës/Doblibare. Pas përfundimit të luftës, mbetjet e tij mortore janë rivarrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Jabllanicë/Jablanica. Ai u shpall dëshmor lufte në vitin 2003.

Burimet: deklarata L.K, FDH-30770; deklarata G.K, FDH-29031; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

Prek (Shaban) Krasniqi

(6.01.1932, shqiptar nga fshati Meqe/Meçe, komuna e Gjakovës/Đakovica, bujk, gjashtë fëmijë)

Prende (Sadri Merturi) Krasniqi

(22.02.1935, shqiptare nga fshati Meqe/Meçe, komuna e Gjakovës/Đakovica, amvise, gjashtë fëmijë)

Pren (Sadri) Merturi

(4.10.1933, shqiptar nga fshati Meqe/Meçe, komuna e Gjakovës/Đakovica, bujk, nëntë fëmijë)

Mire (Shaban Krasniqi) Merturi

(23.10.1934, shqiptare nga fshati Meqe/Meçe, komuna e Gjakovës/Đakovica, amvise, nëntë fëmijë)

Preku me bashkëshorten Prenden e kishin një djalë dhe pesë vajza. I biri i punonte në Gjermani, ndërkaq të bijat ishin të martuara në Kosovë. Ndërkaq, të gjithë fëmijët e Prenit dhe Mires punonin në Zvicër. Që të dy qiftet bashkëshortore jetonin në shtëpitë e veta përkaj rrugës së asfaltuar, në afërsi të postbllokut policor në fshatin fqinj të Kramoviqit/Kramovik [Rahovec/Orahovac]. Gjatë ndërrimit të ndërresave të rojës në këtë postbllok, policët gjithë një shtënin kur kalonin pranë shtëpive të këtyre familjeve. Për këtë arsye, ata kaluan në shtëpinë e Kolë Merturit, i cili ishte në mërgim. Bombardime të para serbe të fshatit [**Meqe/Meçe**] kanë filluar më **2.08.1998**, herët në mëngjes. Shumica e familjeve e braktisën menjëherë fshatin, duke u strehuar në pyllin e afërt. Por, Preku me Prenden dhe Preni me Miren mbetën edhe për pak kohë në shtëpi të Kolë Merturit. Familjari i Prekut, Mark Krasniqi, me dylbi pati vërejtur nga pylli se pleqtë ishin fshehur pas murit në oborrin e shtëpisë. Po ashtu, vuri re se forcat serbe kishin hyrë në fshat dhe se shtënin mbi çdo gjë që lëvizte. Dhe në fund, i ka parë pleqtë duke tentuar që të braktisnin fshatin përmes fushës, e cila gjendet në mes të fshatit dhe pyllit. Pasdite, forcat serbe u drejtuan nga pylli ku fshiheshin fshatarët dhe ata nisën të zhvendoseshin drejt fshatit Doblubarë/Doblibare. Në skajin e pyllit, në vendin e quajtur *Lugu i Meqes*, ata kanë hasur në kufomat e Mires dhe Prenes. Ishin të ekzekutuara nga shpina. Afro tridhjetë metra më larg i kanë gjetur edhe trupat e Prekut dhe Prenit. Për shkak të pranisë së madhe të forcave serbe, ata i kanë lënë trupat aty ku ishin. Më vonë, një prift katolik dhe disa pleq nga fshati Doblubarë/Doblibare kanë shkuar në Gjakovë/Đakovica për të marr lejen për varrimin e viktimave. Në datën 6.08.1998, trupat e të vrarëve u varrosën në varrezat e Doblubarës/Doblibare. Pas përfundimit të luftës, më 2.08.1999, mbetjet mortore të Prekut, Prendes, Prenit dhe Mires janë ri-